



NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVA SH.A.
DICTRICT HEATING GJAKOVA J.S.C.

Adresa: "Tirana", pn GJAKOVË, KOSOVË
Tel & Fax: (0390) 26 657;
Tel: (0390) 23 160; 21 780; 21 386

Nr. i Biznesit: 70325312

E-mail:ngrohtorja@ipko.org

K O N T R A T Ë
Për Furnizim me Ngrrohje Qendrore

Furnizuesi:

Emri dhe Mbiemri i konsumatorit

Adresa e konsumatorit:

Grupi i konsumatorëve:

Data e fillimit të furnizimit me energji:

Lloji i tarifës:

Hapësira ngrohëse (m²)

NQ "GJAKOVA"SH.A (tani e tutje "Furnizuesi") furnizon konsumatorin me shërbime të ngrohjes, në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate, rregullave të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), ligjeve, dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë.

Neni 1
Të Drejtat dhe Obligimet e Konsumatorit

Pa cenuar dispozitat ligjore dhe rregulloret e aplikueshme, konsumatori ka të drejta dhe obligime si në vazhdim:

- a) Të pranojë ngrohjen në mënyrën e specifikuar me këtë kontratë dhe marrëveshjen për kyçje (nëse marrëveshja ekziston);
- b) të shfrytëzojë energjinë ngrohëse në përputhje me këtë kontratë dhe të mos shkaktojë pengesa apo devijim në rrjedhjen e energjisë;
- c) të paguajë faturën e ngrohjes në pajtim me tarifat e aplikueshme duke pasur për bazë matësit e energjisë apo sipërfaqen ngrohëse për m² nëse pajisjet matëse nuk janë të instaluara .
- d) të informojë furnizuesin për çdo pengesë gjatë furnizimit me ngrohje;

- e) të informojë furnizuesin në rast të ndryshimit të pronarit, personit të autorizuar, adresës dhe;
- f) pa pëlqimin e furnizuesit është e ndaluar puna e personave të pa autorizuar në instalimet e ngrohjes si dhe ndryshimi i sipërfaqes ngrohëse apo kyçjet ilegale, andaj çdo konsumator që bën veprime të tilla është i obliguar ta kompensoj dëmin konform Ligjit për Ngrohje Qendrore dhe rregullave të Zyrës së Rregullatorit për Energji;
- g) të kompensojë shërbimet e mirëmbajtës së sistemit sekondar sipas "Çmimoreve për shërbimet e intervenimeve në sektorin sekondar të instalimeve të ngrohjes qendrore" të aprovuar nga ZRRE-ja;
- h) të siguroj qasje të lirë punëtorëve të furnizuesit për intervenim në sistemin sekondar dhe të siguroj hapësirë pa pengesë për instalimin e pajisjeve ngrohëse;
- i) të mos bëj shkelje sipas nenit 5 të Rregullit për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë (shfrytëzimi i pa autorizuar i ngrohjes, vjedhja dhe dëmtimi i pajisjeve ngrohëse).

Neni 2

Të Drejtat dhe Obligimet e Furnizuesit

Furnizuesi ka të drejtat dhe obligimet në vijim:

- a) Të furnizoj konsumatorin me energji ngrohëse në mënyrën e paraparë me këtë kontratë e sipas rregullave të aplikueshme në Kosovë;
- b) të faturoj me korrektësi shërbimet e ngrohjes duke pasur për bazë matësit e energjisë apo sipërfaqen për m² nëse matësit e energjisë nuk janë të instaluar;
- c) të kërkoj nga konsumatori pagesën e energjisë ngrohëse të faturuar;
- d) ti ofroj mbrojtje konsumatorit në kuptim të ofrimit të shërbimeve, këshillimeve, zgjidhjes së ankesave të tyre etj;
- e) të njoftoj konsumatorin për arsyet e ndërprerjes në furnizim me energji;
- f) të eliminoj defektet e shkaktuara gjatë furnizimit me ngrohje;
- g) të mbledh të dhënat përkatëse lidhur me konsumin e energjisë nga konsumatori;
- h) të kërkoj kompensim nga konsumatori për kyçje ilegale dëmtim rrjeti apo pajisjeve dhe për çdo veprim tjetër i cili shkaktohet si rezultat i shkeljes së nenit 5 të Rregullit për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë;
- i) furnizimi me ngrohje bëhet për sezonin ngrohës që fillon me 15 Tetor gjerë me 15 Prill të viti vijues e varësisht nga kushtet klimatike, mund të filloj e mbaroj më herët apo më vonë;
- j) furnizuesi ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me ngrohje nëse ekzistojnë arsyet e parapara me Rregullin për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë dhe Rregullit për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, miratuar nga ZRRE-ja.

Neni 3

Depozita e Garantimit

- 3.1** Në interes të zbatimit të kësaj kontrate, furnizuesi mund të kërkoj depozitim garantues, i cili paguhet me para në dorë ose me depozitim në Bankë;
- 3.2** Gjatë kohës sa qëndron depozitimi garantues në Bankë nuk do të llogaritet kamatë;

- 3.3 Depozitimi garantues do t'i kthehet konsumatorit pasi të shkëputet kontrata për furnizim dhe pasi të jenë paguar borxhet e mbetura.
- 3.4 Në rast se depozitimi garantues nuk kthehet në mënyrën e paraparë më lartë, atëherë për vonesë duhet të bartet vlera e kamatës në ____%.

Neni 4 Ndërprerjet në Furnizim

- 4.1 Në rast ndërprerje të furnizimit për shkaqe objektive - pengesa teknike , furnizuesi është i obliguar që sa më shpejt të ndërmarr të gjitha masat e duhura , në mënyrë që furnizimi me ngrohje të normalizohet.
- 4.2 Në bazë të kërkesës së konsumatorit, furnizuesi do t'i ofroj atij informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e ndërprerjeve aksidentale dhe kohëzgjatjen e nevojshme për të sanuar defektet .
- 4.3 Në rast të ndërprerjeve aksidentale të furnizimit me energji ngrohëse, konsumatori duhet të njoftojnë furnizuesin me përpikëri;

Neni 5 Kufizimet e Furnizimit

- 5.1 Furnizuesi mund të bëj kufizime gjatë furnizimit me energji ngrohëse nëse paraqiten shkaqe të arsyeshme siç janë: problemet e papritura teknike apo arsytet tjera, evitimi i të cilave nuk varet nga vullneti i furnizuesit.
- 5.2 Nëse konsumatori kërkon informacione për kufizimet e lartpërmendura, furnizuesi do ta informoj atë.
- 5.3 Për ditët të cilat furnizuesi nuk ka furnizuar me energji konsumatorët për shkak të ndërprerjeve në furnizim, ndërprerjeve aksidentale apo kufizimeve të domosdoshme nuk do të faturoj, dhe fatura mujore do të bëhet me zbritje për aq ditë sa nuk ka pasur ngrohje.

Neni 6 Faturimi dhe Pagesa

- 6.1 Mënyra e faturimit dhe afatet e pagesës së shërbimeve të ngrohjes bëhet në përputhje me nenet 22 dhe 24 të Rregullit për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullit mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulli i Çmimeve) në Kosovë të aprovuara nga ZRRE-ja;
- 6.2 Faturimi i shërbimeve të ngrohjes bëhet në fund të ç' do muaji të sezonit ngrohës dhe konsumatori është i obliguar të paguaj në afat ligjor;
- 6.3 Nëse ekzistojnë borxhe paraprake ato duhet paguar apo ri-programuar në këste mujore në përputhje me Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, miratuar nga ZRRE-ja;
- 6.4 Mos-pranimi i faturës nga ana e konsumatorit apo dorëzimi i ankesës në lidhje me saktësinë e faturës nuk do të suspendojnë obligimin e konsumatorit që të paguaj faturën.
- 6.5 Në rast mos-pagese të faturës brenda afatit të parapara më lartë konsumatori është i detyruar të paguaj kamatë vlera e së cilës do të aprovohen nga ZRRE për çdo vit

fiskal sipas kërkesës së furnizuesit, si dhe ndaj tij të zbatohen dispozitat e Rregullit për Shkyçje dhe Rikycje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë të aprovuar nga ZRRE-ja;

- 6.6 Kyçja, shkyçja dhe rikycja e konsumatorit në sistemin e ngrohjes bëhet sipas procedurave të parapara me ligj, Rregullit për Shkyçje dhe Rikycje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë dhe rregullave relevante të ZRRE-së.

Neni 7

Klauzolat e Gjobave

Shqiptimi i gjobave bëhet në përputhje me nenin 25, 26 dhe 32.6 të Rregullit për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji të aprovuar nga ZRRE-ja.

Neni 8

Zgjidhja e Ankesave

- 8.1 Konsumatori është i obliguar që për çdo ndryshim gjatë furnizimit me ngrohje, çështje faturimi apo çështje tjera të cilat lidhen me furnizimin me ngrohje t'i drejtohet furnizuesit me shkrim;
- 8.2 Zgjidhja e kërkesave, parashtresave dhe ankesave bëhet në përputhje me Rregullin mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të aprovuar nga ZRRE-ja.

Neni 9

Ndërprerja e Kontratës së Furnizimit

- 9.1 Konsumatori mund të kërkojë ndërprerjen e kësaj kontrate nëse lejojnë kushtet teknike, pasi që të kenë përmbushur të gjitha obligimet e tij që rrjedhin nga kjo kontratë dhe të ketë lajmëruar me shkrim furnizuesin;
- 9.2 Furnizuesi i cili ofron shërbimet e ngrohjes mund të ndërpresë këtë kontratë kur ekzistojnë arsyet në përputhje me procedurat e ofruara me Rregullin për Shkyçje dhe Rikycje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë;
- 9.3 Furnizuesi nuk mban përgjegjësi për ngjarjet jashtë vullnetit të tij siç janë: avaritë, vërshimet, tërmetet, zjarret apo veprimet e dhunshme njerëzore, protestat, konfliktet e ngjarje të ngjashme.

Me datë: _____

NQ"GJAKOVA"SH. A

/nënshkrimi i personit të autorizuar/

Me datë: _____

KONSUMATORI

/Nënshkrimi/

(nr. personal i letërnjoftimit)